

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar nje dt.	14.01.2022
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-05/A



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000
Prizren, Republika e Kosovës
www.uni-prizren.com

RREGULLORE PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM NË UNIVERSITETIN "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Prizren, Dhjetor 2021



Në bazë të dispozitave ligjore të nenit 14, pika 3.4, e Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” (tutje referuar si Universiteti), Senati i Universitetit “Ukshin Hoti” në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12.2021 miratoi:

RREGULLOREN PËR ANAGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM NË UNIVERSITETIN “UKSHIN HOTI” PRIZREN

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm¹ për mbajtjen e ligjëratave, përkatësisht ushtrimeve dhe provimeve, kollokfiumeve dhe konsultimeve sipas nevojës.

Neni 2 Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj rregulloreje është neni 13, pika 2.2, 2.3 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe neni 47, pika 1.3, 1.8 dhe neni 48, pika 1.9 të Statutit të Universitetit.

Neni 3 Aktivitetet e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm

Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm ka për qëllim sigurimin e veprimitarisë së qëndrueshme të Universitetit, në përputhje me obligimet e tij, me theks të veçantë në aktivitetet si në vijim:

1. Aktivitete mësimore (ligjërata, ushtrime)
2. Aktivitete konsultative;
3. Mbajtje të provimeve, kollokfiumeve në lëndët në të cilat angazhohen;

Neni 4 Periudha e angazhimit

1. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm bëhet për 1 (një) vit akademik me përjashtim në raste të jashtëzakonshme, Senati mund të shpall konkursin 2 (dy) herë në vit. Sipas kërkesës së njësisë akademike, kontrata mund të lidhet edhe për një semestër varësisht nga fondi i orëve.
2. Konkursi publikohet njëherë në vit dhe atë të paktën 3 (tre) muaj para fillimit të çdo viti akademik.
3. Kontrata për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm lidhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

¹ Bashkëpunëtor i jashtëm për ligjërata dhe ushtrime nënkupton personelin akademik të angazhuar në Universitet, e që në tekstin e mëtejshëm i referohemi me emërtimin bashkëpunëtor i jashtëm.



4. Bashkëpunëtori i jashtëm, bazuar në kontratën e lidhur me Universitetin, ka për obligim të mbajë provimet, të asistojë në provime, në të gjitha afatet e provimeve brenda vitit akademik, përfshirë tri afate të rregullta pas përfundimit të kontratës.

Neni 5

Konkursi për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm

1. Procedura e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm bëhet nëpërmjet shpalljes së konkursit publik.
2. Përjashtim nga pika 1 e këtij neni bëhet për kategoritë si në vijim:
 - 2.1. Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren.
 - 2.2. Profesorët vizitorë nga vendet e tjera, të punësuar në universitetet e huaja (për një numër të caktuar të ligjëratave deri në një semestër), angazhohen me vendim të Senatit. Këshilli i njësisë akademike propozon angazhimin e kësaj kategorie të bashkëpunëtorëve të jashtëm.
 - 2.3. Personeli akademik nga Universitetet publike të Republikës së Kosovës dhe regionit me të cilat Universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi. Këshilli i njësisë akademike propozon në Senat angazhimin e kësaj kategorie të bashkëpunëtorëve të jashtëm. Personeli akademik i kësaj kategorie duhet të dorëzojë në njësinë akademike dokumentet e noterizuara si në vijim: vendimin e marrjes së thirrjes akademike, kontratën e punës dhe diplomat e studimeve (bachelor, master/ekuivalente dhe e doktoratës).
3. Në rast nevojë të njësisë akademike, me kërkesë të arsyetuar mirë dhe të miratuar nga Këshilli i njësisë akademike, Rektori i Universitetit mund të vendos për angazhimin e personelit akademik të Universitetit në procesin mësimor edhe pas moshës së pensionimit, deri në moshën 70 vjeçare në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren.
4. Konkursi për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm shpallet vetëm nëse brenda universitetit nuk ka personel akademik të mjaftueshëm në fushën përkatëse.
5. Konkursi për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm shpallet nga Senati, me propozim të Këshillit të njësisë akademike, të bazuar në nevojat e njësisë akademike për angazhim në ligjërata ose ushtrime.
6. Rektori, me arsyetim të bazuar, në raste të veçanta, mund t’i propozojë Senatit shpalljen e konkursit për angazhim të personelit akademik në njësinë përkatëse akademike.
7. Konkursi për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm i referohet kushteve dhe kriterëve të kësaj rregulloreje.
8. Konkursi për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm publikohet në ueb faqen e Universitetit. Kohëzgjatja e konkursit është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e shpalljes. Në rast të rishpalljes së konkursit, kohëzgjatja e konkursit zgjat tetë (8) ditë kalendarike.



9. Në raste të jashtëzakonshme, me propozim të njësisë akademike, Senati mund të marrë vendim për hapjen e konkursit. Kohëzgjatja e konkursit zgjat tetë (8) ditë kalendarike.
10. Kandidatët aplikant për bashkëpunëtor të jashtëm obligohen t'i dorëzojnë të gjitha dokumentet brenda afatit të konkursit, në kopje fizike të noterizuara dhe në lidhje të fortë, në njësinë akademike përkatëse, për secilën pozitë (pikë të konkursit) që aplikon.
11. Diplomat e kandidatëve aplikant për gradat shkencore të fituara jashtë vendit do të merren në konsideratë vetëm nëse janë të nostrifikuara dhe të dorëzuara para mbylljes së konkursit. Me përjashtim të atyre që kanë thirrje akademike në Universitete publike. Në raste specifike, kur kandidatët aplikojnë në programet studimore në gjuhën boshnjake, turke dhe programet tjera specifike, Këshilli i njësisë akademike mund ta trajtoj këtë çështje sipas interesit të programit studimor, nëpërmjet një propozimi të arsyetuar mirë (për shkak të specifikave).

Neni 6

Kushtet për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

1. Personat e angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm nuk marrin thirrje akademike të Universitetit. Angazhimi i tyre bëhet duke u bazuar në procedurat specifike të përcaktuara në vazhdim të kësaj rregulloreje.
2. Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm, për ligjërata kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:
 - 2.1. Të ketë gradën shkencore doktor i shkencave në fushën përkatëse (për lëndët e arteve, ekuivalente me të).
 - 2.2. Kandidatët të cilët krahas thirrjes doktor i shkencave kanë edhe thirrje akademike, kanë përparësi për t'u zgjedhur.
3. Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:
 - 3.1. Të kenë të përfunduar studimet në nivelin master ose ekuivalent me të, në fushën përkatëse.
 - 3.2. Të ketë notën mesatare jo më të ulët se 8 (tetë) në nivelin e studimeve Bachelor dhe Master, kur angazhohet për herë të parë.
 - 3.3. Të jetë jo më i vjetër se 28 vjeç, kur angazhohet për herë të parë. Përjashtimisht, kur nuk ka kandidat sipas pikës 3.1. dhe 3.2. të këtij neni, kandidatët mund të angazhohen për ushtrime deri në moshën 40 vjeçare nëse kanë gradën Dr. Sc. dhe që plotësojnë kriterin e përcaktuar sipas pikës 3.2. të këtij neni.
4. Në rastin kur më shumë se një kandidat për pozitën përkatëse i plotëson kriteret e pikës 2 përkatësisht 3 të këtij neni, përzgjedhja do të bëhet sipas këtij prioriteti:
 - 4.1. Kandidati me përvojë më të gjatë akademike në fushën përkatëse;



- 4.2. Kandidati me performancë më të mirë të angazhimit paraprak në Universitet²;
- 4.3. Kandidati i gjinisë femërore (në kushte të barabarta);
- 4.4. Në rastet tjera mbetet në diskrecionin e komisionit vlerësues dhënia e përparësisë për kandidatin e caktuar.
5. Nëse asnjëri nga kandidatët e paraqitur në konkurs nuk i plotëson kushtet, sipas pikës 2 përkatësisht 3 të këtij neni, apo nëse nuk konkurron asnjë kandidat, konkursi rishpallet sipas procedurës së njëjtë të përcaktuar me këtë rregullore.
6. Pas rishpalljes së konkursit, vlerësimi i kandidatëve bëhet sipas procedurës së poshtëshënuar:
 - 6.1. Në mungesë të kandidatëve me gradën e doktorit të shkencave (Dr. Sc.) dhe nëse brenda njësisë akademike nuk ka kandidat me gradën e magjistratit (Mr. Sc.) ose masterit (MSc., MA), i cili do të mund të angazhohej për mbajtjen e ligjëratave në lëndën e caktuar, në përputhje me Statutin e Universitetit për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm, për ligjëratë në nivelin Baçelor mund të angazhohet kandidati me gradën Mr. Sc., MSc. ose MA, duke i dhënë përparësi kandidatit që ka të regjistruara studimet e doktoratës.
 - 6.2. Për kandidatin që i plotëson kushtet e pikës 6.1. të këtij neni, Këshilli i njësisë akademike nxjerr vendim për t'ia besuar lëndën nën përkujdesjen e një profesori në marrëdhënie të rregullt pune në Universitet.
7. Në Universitet, nuk mund të angazhohen kandidatët të cilët kanë më shumë se një angazhim në marrëdhënie të rregullt pune apo honorar në institucione publike apo private me pagë primare e sekondare.
8. Në Universitet, nuk lejohet angazhimi i kandidatëve brenda ndonjëres prej strukturave themelore organizative (departament/program apo degë), nëse brenda atyre strukturave të njëjtit kanë marrëdhënie të rregullt pune apo kanë të angazhuar familjarë të ngushtë në relacionin prind-fëmijë, bashkëshort-bashkëshorte, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas).

Neni 7

Formimi i komisionit vlerësues dhe komisionit të ankesave

1. Dekani i njësisë akademike, brenda shtatë (7) ditëve nga dita e hapjes së konkursit, thërret mbledhjen e Këshillit të njësisë akademike, në të cilën merret vendimi për formimin e Komisionit vlerësues dhe Komisionit të ankesave.
2. Komisioni vlerësues dhe Komisioni i ankesave propozohet në nivel të programit/departamentit, apo në nivel të njësisë akademike dhe aprovohet në Këshillin e njësisë akademike.

² Raporti i vlerësimit të performancës lëshohet nga Zyra për sigurimin e cilësisë së Universitetit.



3. Komisioni vlerësues dhe Komisioni i ankesave janë organe me kredibilitet të lartë profesional, akademik dhe etik, dhe secili komision përbëhet prej tre (3) anëtarëve.
4. Komisioni vlerësues dhe Komisioni i ankesave përbëhet prej profesorëve në marrëdhënie të rregullt pune, në njësinë akademike përkatëse.
5. Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të profesorëve, si në pikën 4 të këtij neni, në përbërje të Komisionit vlerësues dhe Komisionit të ankesave, mund të emërohen edhe profesorë të lëmisë përkatëse nga programet tjera studimore të njësisë së njëjtë akademike apo të njësisive tjera akademike të Universitetit.
6. Komisionet dhe kryetarët e komisioneve zgjedhen nga Këshilli i njësisë akademike.
7. Kryetari i Komisionit vlerësues dhe Komisionit të ankesave janë të obliguar që të thërrasin mbledhjet e komisioneve përkatëse, në koordinim me anëtarët e tjerë, të hartojë raportin e vlerësimit/ankesës dhe t'i publikojnë ato në ueb faqen e Universitetit.
8. Komisioni vlerësues dhe Komisioni i ankesave, gjatë hartimit të raporteve, kanë për obligim zbatimin e dispozitave të konkursit dhe të kësaj rregulloreje.
9. Komisioni vlerësues dhe Komisioni i ankesave mban përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit.
10. Administrata qendrore dhe ajo e njësisë akademike obligohet t'i ofrojë Komisioneve përkatëse të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, për secilën pozitë të konkursit.

Neni 8

Procedura e vlerësimit, marrjes së vendimit për angazhim dhe e drejta në ankesë

1. Komisioni vlerësues ka për obligim shqyrtimin e aplikacioneve të të gjithë kandidatëve të paraqitur në konkurs në lëndën përkatëse.
2. Komisioni vlerësues në afat prej pesë (5) ditë pune pas mbylljes së konkursit përgatit raportin vlerësues.
3. Komisioni vlerësues ka për obligim që në raportin vlerësues t'i prezantojë të gjitha faktet relevante për të gjithë kandidatët e paraqitur në konkurs për lëndën përkatëse.
4. Pas publikimit të raportit të Komisionit vlerësues në ueb faqen e Universitetit fillon të rrjedh afati i ankesës. Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë tek Komisioni i ankesave i njësisë akademike, brenda shtatë (7) ditëve kalendarike nga dita e publikimit në ueb faqe të këtij raporti.
5. Komisioni ankesave i njësisë akademike në afat prej pesë (5) ditëve kalendarike pas përfundimit të afatit të ankesave, përgatit raportin e ankesave duke vendosur si vijon:
 - Aprovimin e ankesës së palës;
 - Refuzimin e ankesës dhe lënien në fuqi të raportit të Komisionit vlerësues; dhe
 - Hedhjen poshtë të ankesës (jashtë afatit).



6. Pas përfundimit të raportit të Komisionit të ankesave, Këshilli i njësisë akademike brenda pesë (5) ditëve kalendarike i shqyrton propozimet e Komisionit vlerësues dhe Komisionit të ankesave.
7. Këshilli i njësisë akademike gjatë shqyrtimit të raportit të Komisionit vlerësues dhe Komisionit të ankesave, ka të drejtë të refuzojë mirëpo nuk mund të miratojë të dy raportet. Këshilli i njësisë akademike e njofton Senatin për vendimin e njësisë akademike në lidhje me miratimin e raporteve përkatës dhe Senati vendos për të njëjtën.
8. Nëse ndonjëri anëtar i Komisionit vlerësues apo Komisionit të ankesave ka mendim ndryshe në lidhje me propozimin/raportin e Komisionit përkatës, ai/ajo është i/e obliguar që të paraqes një propozim/raport të ndarë në Këshillin e njësisë akademike. Vlerësimet e raporteve bëhen në përputhje me këtë rregullore. Në raste të tilla, Këshilli i njësisë akademike i diskuton propozimet/raportet dhe mban të drejtë që t'i refuzojë raportet por jo t'i miratojë të dy raportet, qoftë raporte vlerësuese apo raporte të ankesave. Raporti i komisionit apo raporti i veçantë i cili merr më shumë vota në Këshillin e njësisë akademike konsiderohet i miratuar. Në rast të numrit të barabartë të votave, vota e kryesuesit të Këshillit të njësisë akademike është vendimtare.
9. Raportet e Komisionit vlerësues dhe Komisionit të ankesave shqyrtohen dhe votohen në Këshillin e njësisë akademike. Raportet miratohen me shumicë relative të votave të anëtarëve të Këshillit të njësisë akademike dhe propozohen për miratim në Senatin e Universitetit.
10. Vendimi i miratuar i Senatit për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm publikohet në ueb faqen e Universitetit.
11. Kundër vendimit të Senatit, kandidatët e pakënaqur mund t'i drejtohen në shkallë të dytë Komisionit të ankesave në nivel të Senatit në afat prej shtatë (7) ditë kalendarike nga pranimit/publikimit i vendimit.
12. Pas përfundimit të afatit të ankesave, komisioni i ankesave në nivel të Senatit vendos lidhur me ankesën e palës, për këtë vendim Komisioni i ankesave e njofton Senatin në afat prej shtatë (7) ditë kalendarike nga përfundimi i afatit të dorëzimit të ankesave.
13. Sekretari dhe përfaqësuesi i zyrës ligjore të Universitetit, në bazë të dispozitave të Statutit dhe autorizimit të Rektorit, e përfaqëson Universitetin, përkatësisht njësinë akademike në organet vendimarrëse relevante jashtë universitetit.

Neni 9

Nënshkrimi i kontratës për angazhim

1. Pas marrjes së vendimit nga Senati i Universitetit për kandidatët e angazhuar dhe shqyrtimit eventual të ankesave, Rektori nënshkruan kontratat e bashkëpunëtorëve të angazhuar në Universitet.



Neni 10 Të drejtat dhe obligimet

1. Kandidatëve të angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm nuk i takon e drejta në pushim vjetor dhe kompensimin e përvojës së punës.
2. Angazhimi sipas kësaj rregulloreje nuk nënkupton themelim të marrëdhënies së rregullt të punës e as pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.
3. Në rastet kur kandidatët aplikojnë për themelim të marrëdhënies së rregullt të punës në Universitet, aplikohen dispozitat e Statutit të Universitetit për pozitën përkatëse.
4. Kandidatët e angazhuar bartin përgjegjësi ligjore për mënyrën e shfrytëzimit të pasurisë dhe aseteve të Universitetit.

Neni 11 Dispozitat kalimtare

1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje hyjnë në fuqi nga dita e miratimit në Senat, përveç nenit 4 paragrafi 1 dhe 2 të cilët fillojnë të zbatohen nga viti akademik 2022/23.
2. Interpretimin autentik të kësaj rregulloreje e jep Senati i Universitetit.
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen të gjitha rregulloret dhe vendimet me të cilat është rregulluar çështja e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm.

**Kryesues i Senatit të Universitetit
Prof. Asoc. Dr. Samedin Krrabaj**